



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

RAPORT NGA MONITORIMI I FAUNËS PËRMES KAMERAVE KURTH

Dhjetor 2017

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit në zonat e mbrojtura të natyrës, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës - IKMN edhe gjatë vitit 2017 ka vazhduar së realizuari aktivitetin e monitorimit të faunës së egër përmes vendosjes së kamerave kurth në zonat e mbrojtura të natyrës, me theks të veçantë në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Kjo metodë e monitorimit dhe studimit të faunës së egër, e filluar që nga viti i kaluar, është metodë jo-intenzive pasi gjeneron informacion në lidhje me praninë dhe numrin e llojeve të ndryshme, pa i shqetësuar ato edhe pse qëllimi i realizimit të këtij aktiviteti tek ne ka qenë vetëm evidentimi i pranisë së llojeve pa u futur në aspektin kuantitativ e cila mendohet të realizohet në të ardhmen.

Gjatë këtij aktiviteti të përbashkët me zyrtarët e Parqeve Kombëtare e në disa raste në bashkëpunim edhe me përfaqësuesit e OJQ Environmentally Responsible Action group - ERA me seli në Pejë, është bërë vendosja e kamerave kurth kryesisht në pjesët ku besohet se janë zona të mundshme të lëvizjes së numrit më të madh të kafshëve të egra.

Kamerat kurth janë aparate me shkrepje automatike, të pajisura me një sensor i cili detekton lëvizjen e kafshëve me gjak të ngrohtë dhe i fotografon ato në momentin që kalojnë përpara pajisjes. Këto pajisje montohen në drunj apo kunjat të posaçëm.

Gjatë kësaj periudhe kamerat kurth janë vendosur në këto lokalitete brenda territorit të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”:

1. Bjeshka e Kozhnjerit dhe Maja e Ropsit (te Bazeni), pjesa që i takon K. së Deçanit.

Kamerat në këtë pjesë të parkut janë vendosur vazhdimisht gjatë gjithë vitit duke ditë rëndësinë që ka kjo zonë për praninë e llojeve të rrezikuara të faunës së egër me theks të veçantë të rrëqebullit.

Nga kontrollimi i vazhdueshëm i kamerave, përveç llojeve të zakonshme të faunës së egër që janë hasur vazhdimisht në këtë zonë edhe atë: Lepuri (*Lepus europaeus*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), vjedulla (*Meles meles*), Ketri (*Sciurus vulgaris*) etj. pas një periudhe bukur të gjatë të përcjelljes së gjendjes së faunës përmes kësaj metode, për herë të parë me 18 dhjetor 2016 u konstatua se ishte fotografuar lloji i rrallë dhe shumë i rrezikuar i Rrëqebullit ballkanik (*Lynx lynx ssp. balcanicus*).




Foto 1- 2. Fotot e Rrëqebullit ballkanik të hasura me kamerën kurth

1. Ky lloj më parë është konstatuar në kamerat kurth të vendosura nga ana e OJQ ERA ne rajonin e Rugovës por është hera e parë që haset në kamerat e vendosura nga ekipa e IKMN-së në këtë pjesë të Parkut Kombëtar. Meqenëse secili rrëqebull ka gëzof të ndryshëm (distinct coat patterns), në fotot që morri OJQ ERA nga kamerat kurth është vërtetuar që individit i Deçanit dhe i Rugovës kane gëzof të ndryshëm. Kjo na jep të kuptojmë që individët nuk janë te njëjtë. Gjithashtu për të konfirmuar këtë çështje është dashur edhe ndihma e eksperteve brenda rrjetit BLRP.
2. Prania e një numri të konsiderueshëm të llojeve të shtazëve me të cilat ushqehet ky lloj i rrallë dhe autokton i faunës sonë, pra i gjahut të tij siç janë lepuri, kaprolli, ketri, derri i egër etj., tregon për kushtet e volitshme për ekzistencën e tij në këtë zonë të Parkut.

Me propozim të përfaqësuesve nga OJQ ERA, zona në të cilën është evidentuar prania e rrëqebullit ballkanik për herë të parë, edhe ato disa here radhazi gjatë viteve 2016 dhe 2017, në kuadër të territorit të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është përgatitë harta me zonën e propozuar për Rezervat strikt të këtij lloji të rrallë me rreth 550 ha.

PROPOZIM-REZERVATI I RREQEBULLIT
PARKU KOMBETAR "BJESHKET E NEMUNA"




Foto e Rezervatit të propozuar për ruajtjen e rrëqebullit ballkanik

Gjithashtu gjatë muajit Mars kamerat e vendosura në këtë pjesë përsëri kane kapur Rrëqebullin në lëvizje por nga kualiteti i dobët i fotografive nga kamerat kurth sikurse edhe ne rastin e parë nuk vërehet gjinia e individit e as ajo se a është kapë individi i njëjtë apo bëhet fjalë për më tepër se një individ.

Zona e Kozhnjerit tani më llogaritet një strehë e shumë kafshëve të egra e ndër to edhe e Rrëqebullit të Ballkanit, si lloji i rrallë dhe i rrezikuar në mënyrë kritike si në vend ashtu edhe më gjerë.



Foto 3- 4. Fotot e Rrëqebullit ballkanik të hasura me kamerën kurth

Llojet tjera të kafshëve të egra të hasura në këtë pjesë të parkut janë të paraqitura si më poshtë:



Foto 5- 10. Disa nga llojet e hasura me kamerën kurth në zonën e Kozhnjerit

2. Grykë e Junikut, te Ura e Jedoves, në kuadër të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, pjesa që i takon Komunës së Junikut.

Në këtë pjesë të parkut fillimisht kamerat ishin vendosë qysh në muajin nëntor të vitit 2016 por për shkak të kushteve atmosferike dhe borës së madhe ekipet e IKMN-së nuk e kanë parë të arsyeshme ndërrimin e lokacionit për këtë kamerë deri në muajin shkurt 2017.

Pas kontrollimit të kamerave u konstatua se ishin fotografuar llojet e gjitarëve si: Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Ujku (*Canis lupus*), Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Lepuri (*Lepus europaeus*), Vjedulla (*Meles meles*) etj.

Vlen të përmendet prania e ujkut në këtë pjesë meqë shumë rrallë është hasur në të gjitha kamerat e vendosura në të dy Parqet Kombëtare përgjatë dy viteve të fundit.

Nga prania e numrit të konsiderueshëm të llojeve të evidentuara mund të konstatohet gjendja relativisht e mirë e faunës në këtë pjesë të parkut. (foto 1-4)



Foto 11- 14. Disa nga llojet e hasura me kamerën kurth

3. Periferi të fshatit Llutovë në rajonin e Grykës së Rugovës, në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri” pjesa që i takon Komunës së Pejës.

Pas kontrollimit të kamerës e cila ka qëndruar nga dhjetori i viti 2016 e deri në mars 2017 u konstatua se ishin fotografuar llojet e gjitarëve si: Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Kunadhja (*Martes martes*), Lepuri (*Lepus europaeus*), etj.

Nga prania e këtyre llojeve të gjitarëve në këtë zonë e cila jo rrallë frekuentohet nga fshatarët e kësaj ane mund të konstatohej gjendja relativisht e mirë e faunës edhe në këtë pjesë të parkut.




Foto 15 – 18. Disa nga llojet e hasura me kamerën kurth në afërsi të fshatit Llutovë

4. Grykës që shkon tek Stanet e Erenikut - pjesa e Livadhit të Madh, në kuadër të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, pjesa që i takon Komunës së Junikut

Kamera e vendosur në këtë pjesë dhe e kontrolluar vazhdimisht nga ekipet e IKMN-se në bashkëpunim me ata të DAPK “B. e Nemuna” ka evidentuar praninë e llojeve të gjitarëve si: Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Ari i murrmë (*Ursus arctos*), Maca e egër (*Felis sylvestris*) si dhe disa lloje tjera që nuk vëreheshin mirë.

Nga prania e numrit të madh të këtyre llojeve mund të konstatohet gjendja e mirë e faunës në këtë pjesë të parkut e sidomos e kaprojve që janë hasur në numër më të madh se llojet tjera.



Foto 19 – 22. Foto nga shtazët e egra të fotografuara tek Livadhi i Madh

5. **Grykë e Junikut, zona e ashtuquajtur “te Bazenti”, në kuadër të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.**

Me këtë zonë për një periudhë rreth tremujore kanë qenë të vendosur dy kamera kurth, gjegjësisht njëra në vendin e quajtur Livadhi i Madh ndërsa kamera e dytë në vendin e quajtur “te Bazeni”, pjesë ku supozohet se ka lëvizje të konsiderueshme të faunës së egër.

Pas kontrollimit të kamerave u konstatua se ishin fotografuar një numër i konsiderueshëm i llojeve të shtazëve të egra, e ndër to: Lepuri (*Lepus europaeus*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), etj. (Foto 1 dhe 10).





Foto 23 – 28. Fotot e shtazëve të hasura me kamerën kurth

Me gjithë praninë e madhe të bagëtive si dhe qarkullim e banorëve në këtë zonë, mund të konstatohet gjendja relativisht e mirë e faunës edhe në këtë pjesë të parkut.

Në dy lokalitete në kuadër të Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” janë ende të vendosura kamerat kurth nga të cilat së shpejti priten rezultate. Këto kamera janë të vendosura:

- a. Në Grykë të Junikut, në kuadër të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” pjesa që i takon Komunës së Junikut.
- b. Në Grykë të Deçanit, në kuadër të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” pjesa që i takon Komunës së Deçanit.




Fig.1. Harta me vendndodhjet e mëparme të kamerave kurth (1-5) si dhe atyre ekzistuese (a-b)



Pamje nga vendosja e kamerave ne disa lokalitete brenda territorit te Parqeve Kombëtare

Përfundim

Marrë në përgjithësi, nga prania e numrit të konsiderueshëm të llojeve të ndryshme të faunës së gjitarëve mund të konstatohet gjendja relativisht e mirë e faunës në ato pjesë të parkut ku janë vendosur kamerat. Kamerat e vendosura deri më tani kanë siguruar të dhëna të besueshme për praninë e llojeve të ndryshme të shtazëve të egra në këto zona të mbrojtura.

Shqetësues paraqitet fakti në disa pjesë të parkut ku ende vazhdojnë prerjet ilegale të pyjeve si dhe ndërhyrjet tjera në shkatërrimin e vlerave natyrore e që nënkupton edhe shqetësim të botës së egër dhe në të njëjtën kohë edhe shkatërrim të habitateve të tyre.

Me qëllim të ruajtjes së fondit të shtazëve të egra si dhe evidentimit të llojeve prezente në zonat e mbrojtura të natyrës propozohet:

- Vazhdimi edhe më tutje i aktivitetit për monitorimin e faunës së egër jo vetëm në Parqet Kombëtare por edhe në zonat tjera të natyrës,
- Furnizim me pajisje më të sofistikuara për monitorim të faunës,
- Parandalimi i aktiviteteve ilegale në zonat e mbrojtura që kanë efekte në gjendjen e përgjithshme të faunës së egër siç janë gjuetia, prerja e pyjeve, shkatërrimi i habitateve etj.
- Pajisja me leje hulumtuese e të gjitha Organizatave Joqeveritare që merren me monitorimin e faunës përmes kamerave kurth dhe pajisjeve tjera brenda zonave të mbrojtura të natyrës,
- Bashkëpunim me të gjitha institucionet hulumtuese vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve për monitorimin dhe inventarizimin faunës vendore, me theks të veçantë shpendëve dhe gjitarëve.